



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.11.2020 të parashtruar nga OE "Vlera SHPK", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunes së Prishtinës" me Nr. të Proc: 616-20-3281-221 dhe numër të brendshëm: 616 20 096 221 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE "Vlera" Shpk të dt. 31.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunes së Prishtinës", me Nr. të Proc: 616-20-3281-221 dhe numër të brendshëm 616 20 096 221.
2. Autoriteti Kontraktues vazhdon aktivitetin sipas Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të publikuar me datë: 26/11/2020.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE "Vlera" Shpk me datë 30.11.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi i objekteve për nevojat e Komunes së Prishtinës".

Autoriteti Kontraktues, me datë 03.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimet tuaja se ju keni dorezuar sqarime për paisje është i sakte, mirepo komisioni profesional ka konstatuar se ato nuk janë paisje sipas specifikave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues;
- Poashtu pretendimi juaj se me sqarimet e dorezuara keni paraqitur edhe dokumentet MSDS dhe Çertifikatën e analizave të preparatit është i sakte, mirepo preparati i paraqitur nga ju nuk plotëson kërkesat e Aneskit 1 të Autoritetit Kontraktues, pasi që nuk është me përberjen e kërkuar;

-Pretendimi se tenderuesi i prpozuar per kontrate nuk ka çertifikata valide eshte i pa bazuar,pasi qe ato jane verifikuar nga Autoriteti Kontraktues dhe jane valide;


-Pretendimi se tenderuesi ka dorezuar vetem nje pompe elektrike ULV poashtu eshte i pa bazuar,pasi qe jane verifikuar te gjitha paisjet dhe eshte konstatuar se i posedon te gjitha paisjet e kerkuara;dhe

-Pretendimi se kontratat jane te pa noterizuara poashtu eshte i pa bazuar,pasiqe nuk ka qene kerkesa e AK-se qe te noterizohen.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit